

Gjuha është element aq i qenësishëm për politikën sa që është pikërisht përdorimi i gjuhës që i formon institucionet. Mjafton të përmendim betimin përpara gjyqit si rastin më të përdorur në literaturë për të ilustruar një akt gjuhësor (Austin 1962, Searle 1969). Përsa i përket diskursit politik, në kuptimin më të ngushtë të fjalës, është e pamohueshme që ligjërimi luan një rol vendimtar në mbarështimin publik të pushtetit, jo vetëm përse u përket aspekteve performuese, por mbi të gjitha për mënyrat me të cilat shfrytëzohet për të përfituar dhe mbajtur pajtueshmërimë (Santulli, 2005:15).

Vërtetësia e një thënieje apo besueshmëria e saj është produkt i një zinxhiri kompleks rrethanash kulturore e psikologjike. Sipas këndvështrimit epistemologjik Habermasian paraqitja e një bote objektive nuk është neutrale, ajo varet nga ajo që ne e quajmë gjuhë (Habermas 1971, 1973, 1979, 1981). Ky pozicionim e shikon sjelljen gjuhësore si një medium nëpërmjet të cilit realizohet ‘racionalja’ (Chilton, 2004: 44). Nga këndvështrimi i politikës, besueshmëria e një thënieje varet nga “kredibiliteti” i aktorit politik (Fetzer, 2002).

Që nga Aristoteli gjuha e politikës shihej me veshjen e retorikës. Retorika për Aristotelin ishte një aftësi për të zbuluar në çdo argument atë që ishte në gjendje të të mbushte mendjen (Bregasi, 2015). Kjo karakteristikë themelore e retorikës, pra aftësia për të krijuar bindje në publik nëpërmjet ligjërimit, kënaqte nevojat e subjekteve politike, të cilat me anë të fjalës ushtronin pushtetin. “Objektivi i një diskursi politik është të tregojë pranimin e një opinioni nëpërmjet argumentimeve ose anasjelltas, ta marrë si të pranuar një opinion, për të arritur në përfundime të mëtejshme. Në rastin e dytë kemi të bëjmë me diskursin e propagandës klasike” (Baldi, Savoia, 2010:181). Në këtë diskurs nuk shtrohet pyetja mbi faktin a flitet mbi të vërtetën apo jo, por a u arrit të bindet publiku a jo.

Individët i lidhin format logjike që perceptojnë nga thëniet e të tjerëve me përfaqësueset e tyre mendore të realitetit që rrjedhin nga perceptimi dhe kufizohen nga aparati i tyre kognitiv (Chilton, 2004:50). Pra, përdorimi i gjuhës bashkë me përvojën, besimet e dijen për botën që ka secili individ krijon kuptime në mendjen e tij. Përdorimi i gjuhës politike ka qëllim pikërisht modifikimin e kësaj dijeje.

Analiza e fjalimeve të Enver Hoxhës në këtë punim do jetë një shqyrtim i paraqitjeve të skemave mentale të stimuluar nga diskursi i tij. Bota e

diskursit ose ontologjia e diskursit ndërtohet nga lidhje fjalish në mënyrë të tillë që të krijojnë atë lloj 'realiteti' që synohet nga folësi, i cili paraqitet si një besimtar i atij realiteti. Kjo lloj analize mund të bëhet në nivele të ndryshme të strukturës gjuhësore, por ky punim është bazuar në qasjen kognitive për analizën e diskursit.

Për van Dijk (1987) strukturat retorike janë një hap më tutje gramatikës e diskursi manifeston stilin, si një formë karakteristike e variacionit gjuhësor, që shfaqet në nivelin sipërfaqësor të njëjtimimit, sintaksës dhe leksikut. Stili zakonisht përkufizohet edhe si alternativa të ndryshme për të dhënë të njëjtin kuptim. Strukturat retorike ndryshe nga stili, sipas van Dijk (1987), nuk janë pjesë integruese e vetive të diskursit, por janë opsionale, janë struktura "ekstra" në të gjitha nivelet e analizës gramatikore. Strukturat retorike mund të përkufizohen si shndërrime të posaçme të strukturave gramatikore, si shtesa, fshirje, këmbime, apo zëvendësime, si në rastet e aliteracionit, ritmit, paralelizmave në nivelin morfosintaksor, dhe metaforat, ironizimet apo nënkuptimet në nivelin semantik (v. Dijk, 1987:34-35).

Diskursi politik ka strategjitë e tij të dhënies së informacionit, të cilat synojnë manipulimin. Informacionet modalizohen në terma epistemikë (di/ besoj) dhe në terma të manipulimit bëj-të jetë, bëj-të besojë, bëj-të dijë (Baldi, Savoia, 2010:183). Ligjërimi në diskursin politik shfrytëzon traditën historike e kulturore të masës duke prekur emocionet e saj (Bregasi, 2015). Loja me emocionet është dëshmuar si strategjia më e efektshme në diskursin politik.

### **Njësitë pragmatike të tekstit**

"Si mund të jetë në pozita revolucionare organizata-bazë e Partisë në fshatin malor Zgjan të lokalitetit të Hysgjokajt, në rrethin e Lushnjës, ku gati të gjitha vajzat që nga 13-14 vjeç e poshtë janë të fejuara dhe disa të martuara të vogla nga prindërit, jashtë ligjit?

Po shkoj akoma edhe më tej. Si mund të jetë në pozita revolucionare e gjithë organizata e Partisë e rrethit të Lezhës, ku në mënyrë të heshtur është bërë ligj zakoni i poshtër i shitjes së vajzave për martesë?" (E. Hoxha, 1967, 3-4).

Retorika e dy fjalive të mësipërme, të vendosura që në fillim të diskursit të Enver Hoxhës të vitit 1967, është strategji e efektshme për të mbështetur 'luftën e madhe për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë'. Përzgjedhja e vajzave të vogla, të fejuara, të martuara apo të shitura nga familjet, jashtë ligjit të Partisë, krijon skema të forta mentale, ku Partia del si e vetmja mbrojtëse e fëmijëve e cila e ka për detyrë t'i shpëtojë vajzat nga familjet e tyre. Këtu kemi ndërthurjen e tri njërive pragmatike njëra me tjetrën: detyrimin, legjitimitetin e jolegjitimitetin dhe paraqitjen apo keqparaqitjen.

Të dhënat që paraqet teksti nuk janë të vërtetueshme, thjesht jepen si të vërteta të pastra. Nuk dihet nëse paraqitja e rasteve është e vërtetë apo kemi keqparaqitje. Legjitimiteti i folësit konfirmohet duke akuzuar organizatat e partisë së dy zonave. Detyrimi gjen mbështetje te ligjet e shtetit.

Chilton and Schäffner (1997: 211–15) paraqesin tri strategji kryesore të përdorimit të gjuhës me funksione politike.

**Detyrimin.** Këtu përfshihen urdhrat, komandat, sanksionet, ligjet. Edhe pse detyrimi nuk është funksion i pastër gjuhësor, por varet nga pushteti i folësit, aktorët politikë e shfrytëzojnë në hartimin e agjendave të tyre, në përzgjedhjen e çështjeve që diskutojnë, duke pozicionuar veten dhe të tjerët në lidhje të caktuara dhe duke dalë në përfundime të cilat dëgjuesi është i detyruar t'i pranojë si kusht për të vazhduar procesimin e fjalimit. Chilton and Schäffner e shohin si detyrues edhe simulimin strategjik të efektit, pra lidhjen mes strukturave të kuptimeve dhe qendrave emocionale të trurit. Thënë më thjesht, disa lloj tekstesh mund të simulojnë hormone të caktuara dhe efekti bëhet automatik (Chilton, 2004:46).

**Legjitimiteti dhe jolegjitimiteti.** Legjitimiteti është i lidhur ngushtë me detyrimin sepse përcakton të drejtën për t'u bindur. Çfarë i detyron njerëzit t'u binden politikave me të cilat ata nuk pajtohen? E drejta për t'u bindur u është komunikuar gjuhësisht. Jolegjitimiteti është çdo gjë që ndodhet në anë të kundërt të legjitimitetit: të tjerët (të huajt, armiqtë, opozita institucionale, opozita jozyrtare) duhet të paraqiten negativisht dhe teknikat për këtë përfshijnë paraqitjen e ideve të ndryshme dhe kufijtë nëpërmjet akteve gjuhësore të dhënies së fajit, akuzave, ofendimeve etj.

**Paraqitja dhe keqparaqitja.** Pushteti ushtrohet në nivele të ndryshme në dy kahje, duke kontrolluar informacionin që u jepet të tjerëve, censura, ashtu si edhe informacionin që u lejohet të tjerëve të marrin. Kontrolli politik që është kontroll i informacionit, pra edhe i diskursit, mund të jetë sasior ose cilësor. Të mbajturit sekret (sekret shtetëror) është strategjia e të penguarit të njerëzve për të marrë informacion, e kundërta e censurës. Pra informacioni jepet, por në masë jo aq sa duhet për interesat e dëgjuesëve. Keqinterpretimi cilësor është thjesht gënjeshtër në paraqitjen e tij ekstreme.

Këto tri funksione të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën në praktikë dalin me shumë vlerë në analizën tonë, sikurse del edhe në citatin e mësipërm.

## **Koncepti i fytyrës**

Fjalimi i 1967 fillon me 'dhënien llogari' të komunistit si kërkesë imediate për revolucionarizim të jetës.

"Dhënia llogari dhe zgjedhjet janë një ngjarje me rëndësi të madhe për forcimin e mëtejshëm të Partisë. Në mbledhjet për këtë qëllim çdo komunist duhet të bëjë bilancin e punës së tij dhe të organizatës, të peshojë

me frymën e kritikës dhe të autokritikës sukseset e të metat, të caktojë objektivat për arritjen e të cilëve do të luftojë në të ardhmen, të zgjedhë sekretarin, byronë apo komitetin nga gjiri i shokëve që kanë punuar mirë, që janë treguar organizatorë të aftë, luftëtarë të vendosur për zbatimin e vijës së Partisë.” (E. Hoxha, 1967)

Dhënia llogari si ‘një shkollë e madhe për revolucionarizimin e kuadrove të Partisë’, përtej retorikës, nuk është gjë tjetër veçse dehumanizim i individit në mbledhjet e Partisë. Këtu duhet të shpjegojmë konceptin kyç të akteve gjuhësore, që është ai i fytyrës (Goffman, 1967).

Te ‘Rituali i ndërveprimit’ Goffman (1967) kur flet për lojën e fytyrave, i jep një shpjegim të tillë të termit: Termi fytyrë mund të përkufizohet si një vlerë pozitive që një person mban për vetveten nëpërmjet asaj që të tjerët do të mendojnë gjatë një kontakti me të (Goffman, 1967:7). Pra, me këtë koncept nënkuptohet një imazh pozitiv që një njeri mban për vetveten që edhe të tjerët e mbështesin. Një person krijon “një lidhje sentimentale” me imazhin e tij, fytyrën, të cilën e ka arritur me kohë nga kontakti me të tjerët dhe kërkon që gjithmonë ta konfirmojë këtë imazh, nëse ky imazh do të shfaqet inferior ndaj pretendimit të tij, personi do të ndihet keq, i lënduar në krenarinë e vetë (Bregasi, 2015). Lidhja që një person ka me imazhin e vetë dhe thjeshtësia me të cilën ai mund t’i vihet në dyshim shpjegojnë në një mënyrë arsyen pse për çdo njeri kontakti me të tjerët është mjaft angazhues (Goffman, 1967:8).

‘Dhënia llogari’ është sfida më e madhe që mund t’i kërkohej njeriut. Përpara kësaj kërkesë që del kundër natyrës sociale të njeriut, të heqë dorë nga “fytyra e vetë” për të mirën e Partisë, është e kuptueshme se faktet ku do mbështetej ‘legjitimiteti’ i kërkesës duhet të ishin të të njëjtave përmasa. Shitja e vajzave të vogla nga familjet e tyre është skema mentale ku morali dhe politika ndërthuren shkëlqyeshëm për të krijuar emocione të forta.

Morali dhe politika nuk janë ide abstrakte, por ide të trupëzuara, që funksionojnë më së shumti në ndërdijen kognitive – në atë çka truri juaj është duke bërë e ju nuk mund ta shihni (Lakoff, 2009:10).

## **Teoria kognitive**

Bazuar në natyrën komplekse të fakteve që analizohen, nuk mund të mendohet dot një analizë diskursi në aspektin semantik pa marrë parasysh dimensionin kognitiv të gjuhës. Gjuhësia mentaliste diskursin politik e sheh si produkt të një procesi mental të individit dhe kolektivit. “Ajo përpiqet të tregojë se si politika, diskursi politik dhe ideologjitë politike përfshijnë magazinimin e memories afatgjatë (si personale ose ‘episodike’ dhe sociale ose ‘semantike’). Memorja afatshkurtër merret me proceset që ndodhin ‘online’, pra me prodhimin e diskursit dhe me të kuptuarit e tij, duke gjeneruar

modele mentale të përmbajtjes dhe të kontekstit” (Chilton, 2003: 52). Pra paraqitjet e diskursit politik prekin të dyja rrafshet, qoftë magazinimin e memories si një informacion që tregon vlerat, idetë dhe praktikat e një shoqërie, ashtu edhe realizimin konkret të tij në një kontekst të caktuar.

### **Kuptimi dhe metaforat**

Përpara se të analizojmë metaforat konceptuale, duhet të ndalemi te koncepti i kuptimit sipas gjuhësisë kognitive.

Në gramatikën kognitive janë tri qasje studimore që merren me kuptimin (shih R. Taylor, 2003, 187-187).

- (i) Qasja gjuhë-botë. Kuptimi studiohet si lidhje mes shprehjeve gjuhësore dhe situatave në botë (perspektiva semasiologjike dhe ajo onomasiologjike). Shprehjet gjuhësore nuk referojnë drejtpërdrejt te bota, por tek entitetet në hapësirat mentale të folësit. Hapësirat mentale mund të jenë të vërteta, pra të referojnë tek entitete reale në botë, ose hipotetike, të imagjinuara apo shpikura, psh jashtëtokësorët ekzistojnë vetëm në hapësirat tona të shpikura mentale.
- (ii) Qasja gjuhë-brendi. Kuptimi studiohet në raportet mes shprehjeve në një gjuhë. Mund të dallojmë raportet paradigmatiche, lidhja mes shprehjeve të ndryshme, dhe raportet sintagmatike, lidhjet mes njësive të cilat bashkërenditen në një shprehje.
- (iii) Qasja konceptualiste. Kuptimi i një shprehjeje barazohet me konceptualizimin në mendjen e përdoruesit të gjuhës. Gramatika kognitive e analizon kuptimin duke u bazuar në tri nocione kryesore: profili, baza dhe fusha. Baza e një shprehjeje është përmbajtja konceptuale që del në mënyrë të qenësishme dhe të detyrueshme nga shprehja. Çdo shprehje gjuhësore profilizon diçka, fjalia profilizon një gjendje apo një ngjarje, folja një veprim etj. Fusha (domain) është një konfigurim i gjeneralizuar i dijes nga përvoja në të cilin arrihet konceptualizimi.

Procesi kognitiv sipas modeleve të teorisë kognitive hedh dritë mbi faktin se si del kuptimi në paraqitjen dikursive të botës, si ndërtohet një argument në mënyrë metaforike ose dhe e kundërta, si e ndërton argumentin një metaforë.

Të menduarit politik është të menduarit metaforik par excellence, përveç kësaj ai sjell plot risi në gjuhë. Literatura vë në dukje një klasë të tërë fjalësh të cilat janë veshur me pushtet pikërisht nga përdorimi që iu bëhet nga drejtuesit politikë për të arritur efektet që ata duan mbi elektoratitn, “është e nevojshme të theksohet përdorimi i gjerë i neologjizmave, huazimeve të huaja, eufemizmave, përveç përdorimit të prapashtesave – të përshtatshëm për konotimin e lemave për krijimin e fjalëve të reja- p.sh.

të parashtesave: anti-, hiper-, makro-, post-, dhe të prapashtesave: -poli; -metro; -kracia” (Baldi, Savoia, 2010: 182). Edhe figurat e tjera stilistike si hiperbola, eufemizmi, perifrazimet, litota, alegoria, apologjia etj, janë mjete të pëlqyeshme nga politikanët, pasi ato luajnë mjaft mirë rolin e tyre në prekjen e emocioneve (Bregasi,2015).

Në këtë kontekst rolin më të madh e luajnë metaforat, ato që quhen struktura të kuptimit (frame), kuptimet që strukturojnë objektin dhe mënyrën me anë të së cilës perceptohet. Roli i rëndësishëm i metaforës në diskursin politik është objekt studimi i gjuhësisë kognitive (Lakoff 1987, 1993; Lakoff and Johnson 1980, 1999; Lakoff and Turner 1989; Johnson 1987; Turner 1991; Chilton and Lakoff 1995).

Në librin *Metaforat me të cilat jetojmë* (1980), Lakoff dhe Johnson theksojnë tri fakte: a) metaforat janë të gjithëpranishme në gjuhën e zakonshme, b) metaforat në gjuhën e përditshme kanë një nivel të lartë koherence dhe sistematizmi, c) metafora nuk është thjesht mënyrë e të folurit, por është mënyrë e të menduarit, vetë konceptet e paraqitura nga metaforat janë të strukturuar në mënyrë metaforike.

Metaforat konceptuale sipas Lakoff kanë të bëjnë me lidhjen mes dy rrafshëve (domains) të përvojës (mes dy elementeve në të dy rrafshet), rrafshin nistor dhe atë të destinimit, në skema më të mëdha. Rrafshi burimor (source domain) mund të mendohet si një udhëtar që lëviz nga një vend në tjetrin. Rrafshi destinues përkon me të menduarit (shih Tayler, 2002: 488).

<u>rrafshi burimor</u>		<u>rrafshi destinues</u>
udhëtari	përkon me	mendimtarin
pika e nisjes		premisat
pika e mbërritjes		përfundimin
lëvizja		të arsyetuarit

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se të menduarit paraqitet si një proces që e shpie udhëtarin nga një rrafsh në tjetrin. Gjatë këtij udhëtimit ai përshkon linjën racionale të argumentimit, duke lëvizur nga një pikë argumentuese në tjetrën; gjatë këtij udhëtimit ai mund të bllokohet në ndonjë pikë, ndaj procesi i përsëritjes na del si një udhërrëfyes që e drejton dëgjuesin drejt pikës përfundimtare (shih Lakoff dhe Johnson, 1999: 236-7). Diskursi i lidhshimit që është një veprim politik konceptohet pikërisht si një lëvizje metaforike, ndaj aktorët politikë përdorin sistematikisht shprehje si “të ecim përpara, të ndërtojmë të ardhmen, e ardhmja është në duart tona etj”.

Lidhjet metaforike janë procese komplekse kognitive ku veprojnë faktorë të ndryshëm që përfshijnë dijen, kulturën, përvojën, emocionet etj. Chilton thekson se një pikë e rëndësishme në teorinë kognitive të metaforës

janë lidhjet metaforike, të cilat zakonisht janë të pavetëdijshme e përdoren për të nxitur të menduarit, të menduarit mbi rrafshin e destinacionit të keqkuptuar, të paqartë apo kontravers. Kjo ndodh sepse rrafshi burimor kuptohet në mënyrë intuitive dhe ka strukturë gjithëpërfshirëse (holistic structure), që do me thënë se nëse një pjesë e saj pranohet, gjithë të tjerat e ndjekin nga mbas (Chilton, 2003:).

Teoria e shkrirjes (Fauconnier dhe Turner, 2002) nisat nga teoria e metaforave konceptuale duke qenë se ajo lejon korrelacione të shumëfishta apo paraqitje mentale që shkaktajnë konceptualizime të reja të strukturuar si hapësira mentale apo skema që plotësohen nga strukturat e dijes për fusha të caktuara (Grady etj. 1999). Teoria e shkrirjes duhet kuptuar pikërisht si ndërveprim mes dy hapësirave konceptuale, njëra nga struktura konceptuale e rrafshit burimor dhe tjetra nga struktura konceptuale e rrafshit *target*. Shkrirja mes këtyre dy strukturave konceptuale paraekzistuese krijon hapësirën mentale të një situate të veçantë, e cila është një entitet i ri konceptual (Negau, 2013:17).

### Rolet diskursive

Parashtrimi i koncepteve të mësipërme teorike na shërben për të kuptuar se ekziston një numër i gjerë përbërësish që paraqesin kuptimin. Në këtë analizë po huazoj çështjen kyçe që shtron edhe Chilton në studimin e tij ‘Të analizosh diskursin politik’ (Analysing Political Discourse (2003), “kush i bën çfarë kujt, kur dhe ku”. Këto role diskursive përcaktohen nga referentët e diskursit. Skema tipike gjuhësore ku shfaqen këto role është subjekt-folje-objekt.

“Partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë. Të djegin me zjarr zakonet prapanike e t’i këpusin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave. Këto janë probleme moralo-politike me rëndësi të madhe.”(E. Hoxha, 1967).

Argument 1	Lidhja predikative	Argument 2	Argumentet	Shtesat
P-Agjenti kryefjala, emër ose grup emëror	veprim, të qenët kalimtare, jokalimtare, mesore	P-Pacienti objekti gramatikor emër ose grup	e tjera, p.sh. emër, fjali të varura	lidhëzat, ndajfoljet, parafjalët
Partia dhe vendi Agjenti 1 (Partia +Vendi)	duhet të ngrihen në këmbë Të djegin me zjarr T’i këpusin kokën		zakonet prapanike Pacienti cilitdo Pacienti	e që
Cilitdo Agjent	(që) merr nëpër këmbë veprime		ligjin e shenjtë të Partisë	

Në diskursin e politikës përemri ka funksion deiktik, p.sh. përemri ne përdoret për të dhënë identitetin e grupit, partisë, koalicionit. Në fjalinë e parë në tekstin e mësipërm ky deiks nuk është i mjaftueshëm për të shprehur agjentin, vepruesin. Partia dhe vendi përbëjnë subjektin e fjalisë që merr karakter gjithëpërfshirës, duke pasur përbrenda dy deikse: partia=ne, vendi=agjentët jashtë partisë plus edhe deiksi i hapësirës. Skema mentale që krijohet te dëgjuesi është njëjtësimi i partisë me gjithë popullatën e vendit, partia gjithëpërfshirëse që “duhet të ngrihet në këmbë”.

Këtu kemi dy deikse të lidhura në mënyrë komplekse njëri me tjetrin, deiksin social dhe atë hapësinor. Ndërsa deikset sociale, sipas Chilton (2003), dalin nga strukturat sociale dhe lidhjet e pushtetit, deikset hapësinore në diskursin politik lidhen me hapësirat politike apo gjeografike apo me grupet sociale. Teksti i mësipërm është tekst metaforik par excellence ku njerëzit dhe entitetet e tjera pozicionohen në raport të qartë në lidhje me njëri-tjetrin, në hapësirë, kohë dhe modalitet.

## Diskursi

Teksti i mësipërm është akt i pastër gjuhësor. Është i zhveshur nga karakteristikat e diskursit politik siç janë: thëniet joeksplicite, hamendjet, redundanca gjuhësore. Ky tekst, si një pjesë përfaqësuese e një fjalimi të tërë, plotëson skemën e parimeve bashkëvepruese universale ku Grice (1975) veçon si më kryesoret këto: parimi i cilësisë apo i së vërtetës (mos thuaj atë që ti beson se nuk është e vërtetë, mos e thuaj atë për të cilën ke mungesë informatash); parimi i sasisë (jepe kontributin tënd aq sa të kërkohet, mos e jep kontributin tënd më shumë sesa të kërkohet); parimi i rëndësisë; parimi i mënyrës (ji i qartë, anashkalo keqkuptimet dhe dykuptimësinë, ji i shkurtër dhe ji i sitemuar).

Këto parime universale përputhen në masë të gjerë edhe me skemën e Habermas, por Habermas shton edhe dy elementë të tjerë. Sipas Habermas, çdo thënie në çdo përdorim të gjuhës synon të përmbushë katër kushte të vlefshmërisë: kuptueshmërinë (*Verständlichkeit*), folësi dhe dëgjuesi të flasin një gjuhë të kuptueshme. Kjo mund të krahasohet me parimin e mënyrës, sipas Grice;

Vërtetësinë (*Wahrheit*), të thuhet e vërteta pa marrë parasysht besimet apo pritjet e dëgjuesit. Kjo mund të lidhet me parimin e kualitetit të Grice por duke përfshirë edhe parimin e kuantitetit;

Të thuhet e vërteta (*Wahrhaftigkeit*) së cilës folësi i beson e që përkon me qëllimet e tij.

(*Richtigkeit*), tendenca për të pasur të drejtë dhe autoritet për të kryer një akt gjuhësor.

Dy pikat e fundit janë me shumë interes në diskursin politik.



## Përdorimi strategjik i gjuhës

Teksti i drejtuesit të shtetit	Efekti emocional dhe skemat mentale
<p>Si mund të quhet në pozita pararojë ajo organizatë-bazë e Portit në Durrës dhe si mund të quhet <b>në pozita revolucionare</b> ai punëtor i këtij porti që ditën punon mirë, dallohet, bile edhe lavdërohet, kurse në mbrëmje në shtëpi bën <b>ikona kishe dhe i shet në mëngjes në besimtarë privatë?</b></p> <p><b>Punonjësit e Partisë janë tani në gjendje ta bëjnë vazhdimisht këtë diagnozë të domosdoshme të punës</b> dhe duhet të dalin me <b>mjete shëruese</b>, qoftë në një shkallë të përgjithshme për të gjithë Partinë, qoftë për komunistë të veçantë. <b>Ilaci</b> për komunistë të veçantë që nuk kuptojnë, nuk zbatojnë si duhet ose i shkelin normat, është studimi i teorisë marksiste-leniniste, është lufta revolucionare dhe kjo është pjesë e edukimit të përgjithshëm të Partisë në këto drejtime</p> <p>Por gjatë këtij debati do të njihet edhe vlera e njerëzve, <b>sa i vlen lëkura njërit dhe tjetrit</b>. Kësaj i thonë luftë revolucionare në organizatë.</p> <p>Na dëgjo, se edhe ne do të të ndihmojmë të punosh mirë. Por ki mendjen, po gabove, <b>do të të heqim veshin</b>, kurse, po të vazhdosh në gabime, <b>do të të ngremë këmbët</b> dhe dije se <b>s'ka kush të mbron</b>; Partia është e jona, pushteti është yni, jemi ne në fuqi, diktatura e proletariatit është në fuqi, prandaj ne <b>do të ta thyejmë kokën</b> në rast se do të bësh të këqija;</p>	<p>Frika nga dënimi.</p> <p>Frika se besimtari mund të zbulohet.</p> <p>Punonjësit e partisë = punonjës të fabrikës, duhet të prodhojnë.</p> <p>Partia si e vetmja shpëtimtare për popullin. Komunistët janë mjekët që duhet të shërojnë sëmundjen.</p> <p>Identifikimi i së kundërtës me sëmundjen që duhet luftuar.</p> <p>Hitleri i identifikonte hebrejtë me bakteriet.</p> <p>Mjekimin e ka të gatshëm partia.</p> <p>Ankth dhe frikë. Skema mentale e një kafshe që i shitet lëkura në treg. Lufta revolucionare është “e pamëshirshme”.</p> <p>Përshkallëzimi i kërcënimit të drejtpërdrejtë shkon drejt maksimales, ku individi do gjendet tërësisht i pashpresë përballë pushtetit që ka partia, pra folësi.</p> <p>Frikë.</p>

<p>Partia e Punës e Shqipërisë u formua dhe u hodh në një luftë të tmerrshme kundër fashizmit që nuk e kishte parë ndonjëherë njerëzimi. Ishin në balancë fatet e popullit tonë dhe vetëm një parti marksiste-leniniste, si Partia jonë, mund t'i shpëtonte ato, siç i shpëtoi. Pra partia jonë ishte shpata e mprehtë, e ndritur, e pathyeshme dhe e papërkulur në dorën e klasës punëtore dhe të popullit shqiptar.</p>	<p>Legjitimimi i forcës së pushtetit gjen mbështetje të e kaluara. Evokimi i Luftës së Dytë Botërore është sjellje në memorie të rrezikut nga jashtë ku Partia doli 'fitimtare'. Të të njëjtën mënyrë ajo do të fitojë në të ardhmen nga armiq shumë më të vegjël sikurse mund të jetë një komunist i pavëmendshëm.</p>
<p>Shumë gjëra ndodhën në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokracisë popullore që çuan në përmbysjen e regjimit socialist dhe në degjenerimin e partive të tyre. Përse nuk ndodhën këto edhe te ne? Për arsye që thashë më lart dhe përsëri pikërisht për ato arsye nuk ka për të ndodhur asgjë edhe në të ardhmen. A nuk ekziston një koalicion i vazhdueshëm imperialist-revizionist kundër Partisë së Punës Të Shqipërisë dhe Shqipërisë socialiste?</p>	<p>Paralelizmi me vendet e tjera që dështuan shërben si figurë mbështetëse në atë që mund të ndodhë në Shqipëri nëse normat e Partisë nuk zbatohen. Partia si e vetmja garantuese e së ardhmes.</p> <p>Krijimi i rrezikut 'aktual' nga jashtë për të ngjallur pasiguri.</p>

Nga aspekti epistemologjik i tekstit shfaqet qartë që folësi është ai që e njih shumë më mirë realitetin se të tjerët. Është ai që zbulon rreziqet dhe jep recetat për shpëtim nga to. Folësi qëndron nga ana e autoritetit moral dhe ai ka legjitimet për këtë. Çdo njeri që mund të jetë kundër tij është amoral, jolegitim, e për këtë duhet luftuar. Nga aspekti deontik, folësi ka të drejtën të ushtrojë këtë pushtet mbi dëgjuesit sepse ai është në anën e 'raciales supreme'.

Emocionet që krijohen, frika nga rreziku i jashtëm e i brendshëm, janë produkt i skemave mentale që burojnë nga diskursi, nga përzgjedhja e fjalëve, struktura e fjalive. Frika lidhet me frikën nga pushtimi (duke përfshirë memorien historike të Luftës së Dytë Botërore ku folësi e paramendon që një pjesë e dëgjuesëve mund ta kenë ende) dhe frika nga dominimi [...] Ka arsye të fortë të besohet se këto emocione janë ato që kanë evoluuar në mendjen njerëzore për arsye të të mbijetuarit – por çdo përbërës funksional mund të shfrytëzohet në rrethana të caktuara për qëllime të caktuara (Chilton, 2003: 117).

Fjalimi i Enver Hoxhës, i 6 shkurtit 1967, ka karakter të fortë detyrues.

Të gjitha skemat mentale dhe emocionet janë në funksion të qëllimit të folësit, konfirmimin e autoritetit suprem të folësit, logjikës së tij supreme e që jep direktiva të drejtpërdrejta të legjitimizuara nga vetë ai për popullin.

Legjitimiteti i folësit është një element kyç në diskursin e mësipërm.

Nga aspekti gramatikor teksti është ndërtuar kryesisht mbi bazën e vetës së tretë të lidhores, e masa tjetër e foljeve është në urdhërore. Përqindja më e vogël e foljeve është në mënyrën dëftore. Kjo strukturë i jep karakter të fortë detyrues gjithë tekstit i cili është i ndërlidhur me legjitimitetin në raportin: njëri parametër nënkupton tjetrin.

Ky lloj teksti na shpie te koncepti i legjitimitetit në shoqëritë mesjetare sipas Alfonso dhe Escalona (2004) në librin "Building Legitimacy – Political Discourses and Forms of Legitimacy in Medieval Societies": Larg së qëniti një atribut statik i pushtetit, legjitimiteti duhet të mbahet në mënyrë dinamike, duke dënuar rivalët dhe kjo nuk është e vlefshme vetëm në kohën e konflikteve, apo kur rrezikohet pushteti, por si një proces i vazhdueshëm kompetitiv për të siguruar pushtetin (Alfonso dhe Escalona, 2004:11-12).

Të trija njësitë kryesore pragmatike që përmendëm më sipër janë në funksion të qëllimit të folësit: krijimit të një politike centralizuese të cilën ka legjitimitet vetëm ai për ta drejtuar.


Ne nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se Partia jonë ka në bazën e saj centralizimin demokratik, që do të thotë se jeta demokratike, veprimet demokratike të Partisë sonë bëhen nën një udhëheqje të centralizuar, udhëheqje të zgjedhur me format më demokratike nga e gjithë Partia. (E. Hoxha, 1967, f.10)

Politika centralizuese dhe forcimi i pushtetit mbretëror është tipik për zhvillimin e diskurseve legjitimuese në mesjetë (Alfonso, Escalona, 2004:12).


### **Përsëritja si strategji për ruajtjen e koherencës**

Përsëritja ka funksione të ndryshme në diskursin politik, ajo ndikon në ruajtjen e koherencës me pak sforcime, lehtëson të kuptuarit dhe luan rol në lidhjen e tekstit. Kjo redundancë në diskursin e folur e lejon dëgjuesin të marrë informacion menjëherë sapo folësi e ka prodhuar atë (Tannen, 2007:59). Tannen e quan përsëritjen në bisedë "hapësirë e vdekur" prej së cilës përfiton si folësi, pasi gjatë asaj hapësire mendon për informacionin që do të japë më mbrapa, si dëgjuesi, të cilit i shërben për të kuptuar atë që ka dëgjuar. Ndërsa Halliday dhe Hasan (1976) e përfshijnë përsëritjen në taksonominë e mjeteve kohezive, ku ajo ka funksion lidhës dhe referencial.

Në korpusin tonë përsëritja shërben për të mbajtur 'të gjalla' skemat mentale kyçe të diskursit. Nga analiza statistikore e kuptimeve të dhëna nëpërmjet fjalëve që qëndrojnë në raport paradigmantik mes tyre, sipas skemës së mëposhtme:



Skema më e përsëritur në tekst na del skema e mësipërme. Pastaj vijojnë strukturat me ‘dhënien llogari’ me skemën:



dhe vazhdohet me ‘zbatimin; të zbatohet/n normat e partisë; lufta; të luftohet; luftëtarë; lufta e klasave.

Ndërkohë hapësira mentale mbi figurën e komunistin ndërtohet sipas skemës:



Sipas skemës së mësipërme komunisti paraqitet nga folësi si një qenie e gabuar që duhet të korrigjohet, si qenie e sëmurë që duhet shëruar, si një punonjës i partisë (pra ka rol aktiv, anëtarësia partiake shihet si profesion) që është i detyruar të japë e të kërkojë llogari në çdo kohë (raporti mjek-pacient).

Modelet kontekstuale nuk ndërtojnë dhe nuk kontrollojnë vetëm hapësirat nistore të argumentit, por gjithashtu edhe ato të qëllimit (Neagu, 2013:28). Van Dijk thotë se të kuptosh një akt gjuhësor do të thotë të ndërtosh një model mental mbi një fragment aktual apo të ardhshëm, ndërsa qëllimet konsiderohen si modele veprimesh me pasojat e dëshiruara (v. Dijk, 2008:81)

**Përfundim.** Në bazë të analizës së tekstit sipas metodës kognitive dhe të analizës kritike të diskursit, modelet kontekstuale të ndërtuara në fjalimin e Enver Hoxhës të shkurtit të vitit 1967 krijojnë modele mentale që kanë qëllim krijimin e modeleve të veprimeve me gjithë pasojat e dëshiruara nga folësi. Metaforat konceptuale ndodhen në bazë të këtyre modeleve nëpërmjet të cilave krijohet frikë dhe ankth duke instaluar në mendjen e dëgjuesit një botë ‘të re’ revolucionare së cilës ai është i detyruar t’i besojë. Strategjia e përsëritjes shërben për fiksimin në memorie të skemave mentale kyçe që legjitimizojnë pushtetin e forcës të folësit, që ka si pasojë instalimin e pushtetit absolut dhe ekstremisht diskriminues.

Dhënia llogari është tema bosht e diskursit e cila na shpie direkt te koncepti i fytyrës i Goffmanit. Kërkesa për të hequr dorë nga “fytyra” legjitimizon dehumanizimin e individit, si hap të parë për ta hedhur në veprim. Teksti ndërtohet mbi ndërthurjen e tri njësive kryesore të pragmatikës, detyrimin, legjitimizimin/delegjitimizimin dhe paraqitjen/keqparaqitjen në funksion të qëllimit të liderit.

Studime të mëtutjeshme antropologjike janë të nevojshme për të parë mentalitetin që është krijuar në një shoqëri që ka jetuar gati një gjysmë shekulli nën modele të tilla të ligjërit politik të krahasueshme me diskutet politike gjatë sundimeve mesjetare.

## Abstract

Focusing on Enver Hoxha’s speech from 6 Feb. 1967, this essay analyses the dynamics of the political discourse when Albania was sticking to the Chinese cultural pattern. Political discourse is metaphorical discourse by definition. The mental schemes created from their conceptualisation undergo complex cognitive processes which often act on the level of subconsciousness involving knowledge, experience, emotions, etc.

In his speech, the speaker brings together the main three pragmatic tenets: obligation, legitimation/non-legitimation and the presentation/ill-presentation. The ruse contained in the text help legitimise and self-legitimise absolute power.

Hoxha's speech is directed at communists who were supposed to be the eye, the ear, the tongue and the hand of the leader. So, his face could come alive to the hearers.

## **Bibliography**

Alfonso, I., Kennedy, H., dhe Escalona, J.,(2004) Building Legitimacy, Political Discourses and Forms of Legitimation in Medieval Societies.

Austin, J. L. (1962) How to Do Things With Words, Oxford, Clarendon Press.

Baldi, B., Savoia, L., (2009) Lingua e comunicazione, La lingua e i parlanti, Pacini Editore

- (2010) Metafora e ideologia nel linguaggio politico, te Lingua e società, : M. Arcangeli. Lingua Italiana d'Oggi. p. 119-165, Roma: Bulzoni.

Bregasi, M., (2015) Përtej debatit politik. Kolegji Dardania, Prishtinë

Chilton, P. A. (1996) Security Metaphors: Cold War Discourse from Containment to Common House, New York, Lang.

- dhe C. Schäffner (1997) 'Discourse and politics' in T. van Dijk (ed.), Discourse as Social Interaction, London, Sage: 206–30.

- (2002) and C. Schäffner, Politics as Text and Talk: Analytic Approaches to Political Discourse, Amsterdam, John Benjamins.

- (2004) Analysing Political Discourse: Theory and Practice. Routledge London and New York.

Chomsky, N. (1968) Language and Mind, New York, Harcourt, Brace & World.

Dijk, Teun A. van. (1987) Communicating Racism. Ethnic Prejudice in Thought and Talk, London, Sage.

- 2008. Discourse and Context: a Sociocognitive Approach. Cambridge: Cambridge University Press.

- 2002. 'Ideology: political discourse and cognition' në P. A. Chilton and C. Schäffner,

Politics as Talk and Text.

Fairclough, N. (1989) Language and Power, London and New York, Longman.

- (1992) Critical Language Awareness, London, Longman.

- (1995a) Critical Discourse Analysis: the Critical Study of Language, London, Longman.

Fauconnier, G. (1994) Mental Spaces: Aspects of Meaning

Construction in Natural Language. Cambridge: Cambridge University Press.

- (2002) dhe M. Turner. 2002. *The Way We Think: Conceptual Blending and the Mind's Hidden Complexities*. New York: Basic Books.

Fetzer, A. (2002) "Put bluntly, you have something of a credibility problem": Sincerity and credibility in political interviews' në P. Chilton and C. Schäffner (eds), *Politics as Text and Talk*.

Goffman, E. (1967) *Interaction Ritual: Essays in Face-to-Face Behavior*. New York: Pantheon Books. Goffman, E. 1974/1986. *Frame Analysis: An Essay on the Organization of Experience*. Boston: Northeastern University Press.

Grady, J. E. (1999) A Typology of Motivation for Conceptual Metaphor. Correlation vs. Resemblance. Në R. Gibbs Jr. and G. Steen (eds) *Metaphor in Cognitive Linguistics*. f. 79–100. Amsterdam: John Benjamins.

Grice, H. P. (1975) 'Logic and conversation' in P. Cole and J. Morgan (eds), *Syntax and Semantics: 3: Speech Acts*, New York, Academic Press.

Habermas, J. (1984) *The theory of Communicative Action*. Volume 1. Boston: Beacon Press.

Lakoff, G. (1993) *The Contemporary Theory of Metaphor*. In A. Ortony (ed.), *Metaphor and Thought*, f. 202–251. Cambridge: Cambridge University Press.

Lakoff, G. (2002) *Moral Politics: How Liberals and Conservatives think*. Chicago: The University of Chicago Press.

- (2009) *The Political Mind: A Cognitive Scientist's Guide to Your Brain and Its Politics*. New York: Penguin Books.

- (1987) *M. Johnson, Metaphors We Live By*. Chicago: Chicago University Press.

Negau, M. (2013) *Decoding Political Discourse, Conceptual Metaphors and Argumentation*. Palgrave Pivot.

Santulli, F., (2005) *Le parole del potere, il potere delle parole*, Francoangeli

Senellart, M. (1995) *Les arts de gouverner. Du regimen médiéval au concept de gouvernement*

Searle, J. (1969) *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*, Cambridge, Cambridge University Press.

Tannen D., (2007) *Talking Voices*, Cambridge University Press.

Taylor, J. R., (2003) *Cognitive Grammar*, Oxford Textbooks in Linguistics.